

Pozicioni: Inxhinieri Gjeodet ne zyren teknike Tiranë

Rreth nesh

LLAZO sh.p.k., e themeluar në vitin 2002, është një ndërmarrje private familjare me kapacitete të nivelit të parë në të gjithë zinxhirin e shërbimeve në sektorin e ndërtimit. Ne operojmë sipas një modeli të integruar biznesi, i cili përfshin të gjitha fazat: studim, projektim, prodhim, ndërtim, investim, operim dhe mirëmbajtje, duke ofruar zgjidhje të plota për klientët publikë dhe privatë në Shqipëri.

Kompania punëson rreth 100 punonjës dhe realizon një xhiro vjetore mbi 5 milionë euro, duke vepruar në sektorët kryesorë të industrisë së ndërtimit:

Infrastruktura publike

Ndërtim ndertesash

Ujesjelles-Kanalizime

Shpërndarje energjie

Selia qendrore e shoqërisë ndodhet në Lushnjë, ndërsa zyra dytësore në Tiranë mbështet aktivitetin operativ në të gjithë territorin, duke përfshirë edhe Kosovën..

Me shume info: www.llazo.al , Instagram: llazo_official Facebook: LLAZO

Përshkrimi i pozicionit të punës

- Përpunimi i të dhënave gjeodezike (raw data) Microsurvey Starnet dhe transformimi i tyre në sisteme të ndryshme koordinative.
- Modelimi i terrenit dhe përgatitja e vizatimeve teknike në Civil 3D dhe AutoCAD.
- Hartimi i profileve gjatësore e tërthore, krijimi i sipërfaqeve dhe hartave topografike.
- Llogaritja e volumeve të punimeve (gërmime, mbushje, shtresa rrugore, agregate) dhe volumeve të elementeve strukturore (themele, mure, plinte, trarë, pllaka etj.).
- Përgatitja e raporteve teknike, vizatimeve dhe dokumentacionit as-built.
- Menaxhimi dhe administrimi i pajisjeve gjeodezike dhe garantimi i cilësisë së matjeve përmes verifikimeve periodike dhe kontrollit të pajisjeve.
- Analizimi i modeleve 3D dhe sipërfaqeve për të identifikuar probleme të mundshme dhe përmirësime të nga pikëpamja e zbatueshmërisë/buildability.
- Zbatimi i procedurave QA/QC për të garantuar cilësinë e të dhënave dhe dokumentacionit teknik. Merr ne dorezim ose instalon, miremban dhe ruan nga fillimi deri ne perfundimin e projektit pikat gjeodezike te objektit, reperat, pikat e forta, rrjetet gjeodezike etj.
- Mbështetje teknike për ekipin e ofertimit dhe përgatitja e volumetrive kur kërkohet.
- Koordinimi me ekipet teknike për metodologji, feasibility dhe optimizimin e zgjidhjeve në terren.
- Përgatitja e analizave të ndryshme/ planifikimi (lookahead) për aspektet gjeodezike.
- Mirëmbajtja, standardizimi dhe arkivimi i databazave gjeodezike të projekteve.
- Koordinimi i përditshëm me ekipet e projektimit, zbatimit dhe menaxhimit të projektit.

Adresa:

LLAZO sh.p.k
Rr.Kemishtaj, Nd.172
Bishqethem, Kolonje, 9007
Lushnjë, Albania
Nuis: K24218401K

Kontakt:

Tel: +355 69 40 60 907
E-mail: info@llazo.al
Web: www.llazo.al

Aftësitë dhe kualifikimet

- Diplomë universitare në Inxhinieri Gjeodezie
- Eksperiencë e mëparshme pune minimumi 5 (pesë) vite në fushën e gjeodezisë.
- Civil 3D në nivel profesional – kriter bazë dhe i panegociueshëm.
- Njohuri të avancuara në AutoCAD dhe MS Office.
- Preferohen njohuri me softuerë gjeodezikë si Microsurvey Starnet, Leica Infinity, Trimble Business Center etj.
- Njohje shumë e mirë e gjuhës angleze.
- Aftësi analitike dhe vëmendje shumë e lartë ndaj detajeve.
- Aftësi të mira komunikimi dhe punë në ekip.
- Leje drejtimi e klasit B

Çfarë ofrojmë ne

- Paga bazë konkurruese mbi mesataren e tregut.
- Bonus vjetor bazuar në performancë dhe objektiva.
- Pagesë vjetërsie në bazë të viteve të punës.
- Trajnime profesionale dhe certifikime të mbuluara nga kompania (Civil 3D, BIM, teknologji matëse).
- Mundësi reale për avancim në detyrë dhe zhvillim afatgjatë profesional.
- Ambjent pune profesional, bashkëpunues dhe me kulturë të fortë teknike. Aktivitete social-kulturore.

Ne do të bëjmë çmos që ju të ecni përpara!

Ofrojmë mundësitë më të mira për të zhvilluar ambiciet dhe pasionet tuaja profesionale dhe personale. Ofrojmë një vend pune plot mundësi për t'u angazhuar në disa nga projektet më të veçanta të ndërtimit. Ju do të jeni bashkëpunëtorë dhe do të ndërmerrni një rol aktiv në zbatimin e projekteve me impakte pozitive sociale. Do të punoni dhe jetoni çdo ditë në një ambient pune plot energji pozitive, inkurajues dhe plot mbështetje për të drejtuar, mësuar dhe u zhvilluar profesionalisht

Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV-në, diplomën dhe referenca në adresën e email-it: info@llazo.al, me përshkrimin: “Punesimi – Inxh. Gjeodet”, deri më datë 08/12/2025.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë. LLAZO garanton që të dhënat e kandidatëve do të trajtohen me konfidencialitet maksimal.

Adresa:

LLAZO sh.p.k
Rr.Kemishtaj, Nd.172
Bishqethem, Kolonje, 9007
Lushnje, Albania
Nuis: K24218401K

Kontakt:

Tel: +355 69 40 60 907
E-mail: info@llazo.al
Web: www.llazo.al

